

V E N D I M
Nr.23, datë 22.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Franc Jakova,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 22.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.30 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S E : PARTIA E DJATHTE DEMOKRATE, e përfaqësuar nga Z. Agim Zeka.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga sekretari i Komisionit, Z. Kreshnik Spahiu dhe Genci Bektashi anëtar i Komisionit.

O B J E K T I :

Shfuqizimin e vendimit nr.568 Prot., datë 18.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.568 Prot., datë 18.5.1996, ka vendosur rrëzimin e ankesës së Partisë së Djathtë Demokrate për mosregjistrimin e kandidatëve për deputetë të kësaj partie në zonat elektorale nr.115,17,113,33 dhe 31, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 48 të Ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.

Kundër këtij vendimi është ankuar në Gjykatën Kushtetuese Partia e Djathtë Demokrate, duke kërkuar prishjen e tij si të pabazuar në ligj.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përsa i përket shpalljes së ankesës së subjektit elektorale jashtë afatit ligjor, është vetëm pjesërisht i drejtë dhe i bazuar. Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes ka rezultuar se vetëm për kandidatin e zonës nr.17 është marrë vendim mosregjistrimi nga komisioni i zonës me datën 30.4.1996. Për këtë rast ankimi i bërë në Komisionin Qendror me datën 4.5.1996, me të drejtë është rrëzuar për shkak të paraqitjes së ankesës jashtë afatit të parashikuar nga neni 49 i ligjit për zgjedhjet.

Përsa u përket rasteve të zonave të zgjedhjeve nr.31,33,113 dhe 115, ankimi i subjektit elektorale është bërë vetëm për veprime të parregullta të komisioneve përkatëse të zonave. Për këto veprime të komisioneve ligji u ka njohur subjekteve elektorale të drejtën e ankimit në Komisionin Qendror pa e kufizuar këtë të drejtë me ndonjë afat. Si rrjedhojë, Komisioni Qendror ishte i detyruar të shqyrtonte në themel ankimet e paraqitura (neni 36 shkronja “c”).

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim pretendimet e parashtruara lidhur me parregullsitë e komisioneve të zonave dhe arrin në këto përfundime :

1. Në zonën elektorale nr.113, komisioni i zonës pa të drejtë nuk ka pranuar për të regjistruar si kandidate për deputetë Znj. Fiqirete Qoku. Nga procesverbali i mbajtur në komisionin e zonës me datë 27.4.1996 rezulton se dokumentet janë paraqitur brenda kësaj date dhe nuk ka patur asnjë shkak të ligjshëm për mospranimin e tyre.

Prandaj, Gjykata çmon se duhet të detyrohet komisioni i zonës të regjistrojë si kandidate të sipërpërmendurën.

2. Në zonat 115,33 dhe 31 dokumentet për regjistrimin e kandidatëve janë paraqitur tej afatit ligjor (27.4.1996). Kështu vetë pala kërkuuese ka pranuar se në zonën 115 dokumentet i ka paraqitur me datë 29.4.1996, kurse në zonën nr.33 dokumentet i ka paraqitur pas orës 2000 të datës 27.4.1996. Përsa i përket pretendimit se në zonën nr.31 dokumentet i ka paraqitur brenda afatit ligjor, pala kërkuuese deklaroi para Gjykatës se nuk dispononte asnjë lloj prove për ta vërtetuar atë.

Pretendimi se vonesat në paraqitjen e dokumenteve kanë ardhur për shkak të marrjes me vonesë të vendimeve nga Komisioni Shtetëror i Kontrollit të Figurës së Zyrtarëve (datë 26.4.1996), nuk përbën argument ligjor në favor të kërkuarit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pikat 7 e 9 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të nenit 36 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr.8055, datë 1.2.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit nr.568 Prot., datë 18.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përsa i përket zonës së zgjedhjeve nr.113.

Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të komisionit të zonës nr.113 të regjistrojnë dhe të shpallin menjëherë kandidate për deputete Znj. Fiqirete Qoku.

Rrëzimin e kërkesës për zonat e zgjedhjeve nr.115,17,33 dhe 31.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 22.5.1996

Nr. 30 i Regjistrimit themeltar.

Nr. 23 i Vendimit.